

KËRKESË

Nr. 6229/4, datë 28.10.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Energjisë dhe Industrisë shpall kërkesën për shpronësim dhe marrjen në përdorim të përkohshëm për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga ndërtimi i stacioneve të kompresorëve dhe valvulave të bllokimit, shesheve të depozitimit dhe kampeve të punëtorëve në zonat Devoll, Fier, Korçë, Skrapar dhe Berat (pjesë e projektit të gazsjellësit “Trans Adriatik”). Subjekti kërkues i kësaj kërkesë është Trans Adriatik Pipeline AG Shqipëri, shoqëri e cila do të zhvillojë një tubacion të gazit natyror, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, sipas listave emërore bashkëlidhur, mbi masën e vlerësimit të llogaritur në zbatim të ligjit të posaçëm nr. 116/2013, datë 15.4.2013, në përputhje me planin e rehabilitimit të jetesës. Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në listat emërore të publikuara, si dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si dhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit dhe marrjes në përdorim të përkohshëm. Lutemi pronarëve dhe personave që pretendojnë pronësinë mbi pasuritë që preken nga ky projekt, të dorëzojnë çdo dokument që disponojnë pranë ZVRPP-së përkatëse për shënimet e bëra nga ZVRPP-të në listën bashkëlidhur, mbi saktësimin dhe konfirmimin e sipërfaqeve, mungesat e dokumentacionit etj.

**MINISTRI I ENERGJISË
DHE INDUSTRIËS
Damian Gjiknuri**